



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 14 regjistër (JR)
Datë 06.04.2023

Nr. 36 i vendimit
Datë 27.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtaret:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.07.2023, ditën e enjte, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 14/2023 (JR), datë 06.04.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr. 621, datë 13.02.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e Komisioneres Publike Irena Nino, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, konkluzionet përfundimtare të saj, të paraqitura nga Komisioneri

Publik Florian Ballhysa, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 621, datë 13.02.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi propësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
 - 3.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë, ka përcjellë në Komision raportin në të cilin ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklaram të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 3.2. DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 15.02.2022, të KDZH-së, në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.
 - 3.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe

rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 621, datë 13.02.2023, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, pasi ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, si dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

5.1. Për vlerësimin e pasurisë: subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

5.2. Për kontrollin e figurës: subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

5.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale: pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

6. Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), në datën 23.03.2023, ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 621, datë 13.02.2023, duke parashtruar shkaqe ankimi vetëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, të cilat paraqiten si më poshtë.
7. **Për pasuritë: apartament banimi me sipërfaqe 124,27 m², me çmim blerjeje 16.776.450 lekë, dhe bono thesari me vlerë 4.000.000 lekë,** pasuri në vlerë totale prej 20.776.450 lekësh, nisur nga rrethanat faktike të konstatuara gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre pasi rezultojnë këto rrethana objektive:
 - 7.1. Investimi i znj. T. I. në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, rezulton në vlerë të konsiderueshme.
 - 7.2. Investimi në bono thesari është kryer në vitin 2009 dhe investimi në pasurinë apartament me sipërfaqe 124,27 m², është kryer në vitin 2012, për të cilat si burim krijimi pretendohet se janë kursimet nga të ardhurat e përfituara nga puna e të atit, z. A. M., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2005.
 - 7.3. Subjekti ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me nënën e tij, për periudhën minimalisht prej datës 20.5.2005 – 18.4.2012, dhe është larguar nga përbërja familjare vetëm katër ditë pas kryerjes së transaksionit të blerjes së apartamentit nga nëna e tij, rrjedhimisht të dyja pasuritë në

analizë rezultojnë të krijuara nga nëna e subjektit gjatë kohës që ky i fundit ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me të dhe në funksionin gjyqtar.

7.4. Nëna e subjektit, znj. I., nuk mund të ketë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar investimin e këtyre pasurive, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

7.5. Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit mbi konsiderimin e znj. I. si person të lidhur sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësorin e datës 19.4.2022, se këto pasuri janë krijuar me kursime nga të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit, trashëguar nga e ëma pas vdekjes së tij në vitin 2005, nga verifikimi i akteve në dosje, sikundër dhe Komisioni ka konstatuar, rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga punësimi i të atit, provuar me dokumentacion, janë në vlerën 1.898.399 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar investimet e nënës së subjektit në vitet 2009 dhe 2012, llogaritur në vlerën totale prej 20.776.450 lekësh.

7.6. Pretendimet e subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati, nga punësimi apo përfaqësimi në institucionet ndërkombëtare, në vlerën totale prej rreth 511.000 USD, mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara. Të ardhurat e pretenduara nuk u provuan as nga hetimi administrativ i Komisionit, ndërkohë që Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar se nuk i ka paguar të atit të subjektit pagesa shtesë për pjesëmarrjen në misione. Pretendimi i subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati në formë dietash, përveçse i paprovuar, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit mbi trajtimin e të ardhurave në formën e dietës.

7.7. Gjatë hetimit nuk rezultuan gjurmë, akte konfirmimi apo lëvizje të llogarive bankare, si për të ardhurat e pretenduara të përfituara, ashtu dhe për kursimet e pretenduara se janë trashëguar nga nëna e subjektit pas vdekjes së babait të subjektit.

7.8. Deklarimet kontradiktore të subjektit mbi vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2019, krijojnë paqartësi për të provuar se ku ka jetuar dhe me kë ka jetuar subjekti në këto vite. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 01.08.2014, subjekti ka deklaruar se jeton në shtëpinë e nënës, në adresën e dhënë në deklaratimet periodike, rruga “{***}”, Tiranë, e cila jeton me qira dhe pagesa e qirasë, në shumën 25.000 lekë në muaj, paguhet nga ajo. Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimin, për periudhën shtator 2004 - qershor 2019, ka deklaruar si adresë banimi: “Njësia Bashkiake nr. {***}, rruga “{***}”, pallati {***}, Shk. {***}, K. {***}, Ap. {***}”, në apartamentin e marrë me qira prej tij. Ndërkohë, gjatë seancës dëgjimore në Komision, avokati i subjektit ka deklaruar se *deklarimi në ILDKPKI, në vitin 2014, përmban një lapsus, në apartamentin me adresë në rrugën “{***}”, ka banuar vetë subjekti, pasi e ëma, që nga muaji shtator 2005 (moment i shitjes së pasurisë në pronësi të subjektit dhe së ëmës në rrugën “{***}”, Tiranë, e në vijim, ka vijuar të banojë në pasurinë e trashëguar nga prindërit e saj, në rrugën “{***}”, Tiranë. Duke filluar nga data 14.4.2012, ajo ka fituar pronësinë në apartamentit 124,27 m², Tiranë.*

7.9. Nga verifikimi i deklaratave periodike, dorëzuar në ILDKPKI, rezulton se në deklaratat e viteve 2005 - 2016 dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë banimi rrugën “{***}”. Edhe nëna e subjektit të rivlerësimit, bazuar në shkresën nr. {***}, datë 8.9.2020, të Bankës së Shqipërisë, ka deklaruar si adresë banimi rrugën “{***}”. Nga aktet në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë banuar në të njëjtën adresë, edhe pas shkëputjes nga certifikata familjare në datën 18.04.2012.

7.10. Deklarime kontradiktore të subjektit rezultojnë edhe lidhur me vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2013, pasi në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 01.08.2014, subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe, për shkak të marrëdhënies së punës, ka kryer vajtje-ardhje çdo ditë dhe në disa raste, ka jetuar te të njohurit pa pagesë, ndërkohë gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe ka jetuar në apartamentin e marrë me qira në Vlorë.

7.11. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 18.9.2020, të Furnizuesit të Shërbimit Universal, rezulton se për kontratën e furnizimit me energji elektrike të znj. I., për periudhën maj 2012 - maj 2019, nuk ka konsum energjie dhe është paguar vetëm tarifa bazë (340 - 658 lekë në muaj).

7.12. Gjatë seancës dëgjimore, në përgjigje të pyetjeve drejtuar nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ati ka punuar për organizata ndërkombëtare, të cilat sistemin e taksave e kanë të rregulluar me akte të veçanta dhe, rrjedhimisht, të ardhurat e realizuara nuk i nënshtroheshin legjislacionit tatimor shqiptar, pretendim i cili nuk gjen mbështetje, pasi për periudhën në fjalë ka rezultuar se babai i subjektit, z. A. M., nuk ishte pjese e stafit të NATO-s. Bazuar në përgjigjen e Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën nr. {***} prot., datë 6.10.2022, babai i subjektit ka qenë ushtarak aktiv deri në vitin 2002, pjesë e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të shtetit shqiptar.

8. Komisioneri Publik, referuar situatës faktike të përshkruar më sipër, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ka vlerësuar se rrethanat faktike janë të tilla që të krijojnë bindjen se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk kishte burime financiare të mundshme apo të disponuara, për krijimin e pasurive si më sipër, në vlerën 20.776.450 lekë, pasi:

8.1. Të ardhurat e pretenduara nga babai i subjektit të rivlerësimit, përveçse mbetën të paprovuara, duken dhe jo të besueshme, si dhe i përkasin një periudhe kohe të largët (1993 - 2005, referuar pretendimeve të subjektit), nga momenti i krijimit të pasurive (2009 dhe 2012). Përveç burimit të ligjshëm, e paprovuar mbetet dhe mënyra e ruajtjes së të ardhurave/kursimeve të pretenduara, nisur nga shuma e konsiderueshme e tyre.

8.2. Pasuria apartament me sipërfaqe 124.27 m², e blerë nga znj. I., duket që nuk është shfrytëzuar asnjëherë prej kësaj të fundit nga momenti i blerjes e deri në ndërrimin e jetës. Subjekti i rivlerësimit është ndarë nga certifikata e gjendjes familjare, pikërisht disa ditë pas krijimit të kësaj pasurie, rrethanë që duket se është bërë në përpjekje për të fshehur këtë pasuri dhe për të shmangur verifikimet dhe kontrollet që mund të ushtroheshin ndaj tij për pasurinë.

9. Gjithë sa më sipër, parë në harmoni dhe me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit gjatë periudhës 2005-2016, sipas Komisionerit Publik, çojnë në përfundimin se kemi të bëjmë me përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur pasuritë, duke e vendosur këtë të fundit në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
10. Përfundimisht, mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e parashtruara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit, i cili, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:
Ndryshimin e vendimit nr. 621, datë 13.02.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nga Komisioneri Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2, dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh¹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 621, datë 13.02.2023, për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

¹ Sipas dokumentit lajmërim marrjeje, regjistruar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, me numër prot. {***}, datë 09.03.2023.

14. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën gjyqësore publike të datës 04.07.2023, subjekti i rivlerësimit, në vijim të parashtrimeve, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes. Trupi gjykues, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit². Trupi gjykues vendosi nënshkrimin e këtyre akteve debatit gjyqësor dhe, më pas, i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.
15. Në Kolegj janë administruar tri denoncime nga publiku, nga denoncuesit V. Ç.³, D. M.⁴ dhe A. R.⁵, të cilat u janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
16. Subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 04.07.2023, paraqiti shpjegimet e tij lidhur me këto denoncime, shoqëruar dhe me akte. Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me denoncimet e administruara për të në Kolegj, si dhe analizoi dhe shqyrtoi shpjegimet e dhëna dhe aktet e paraqitura në mbështetje të tyre, e konsideroi të ezauruar fazën e verifikimit të denoncimeve, duke vlerësuar se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre, nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, vendosi të mos i konsiderojë ato si me peshë në marrjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes.
17. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

18. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues fillimisht vlerësoi të analizojë statusin ligjor të nënës së subjektit në raport me procesin e rivlerësimit, nëse ajo

² Subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashtrimet, ka paraqitur aktet: 1. kërkesë për informacion, drejtuar Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, e datës 29.03.2023, bashkëlidhur mandati postar; 2. kërkesë për informacion, drejtuar Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, e datës 29.03.2023, bashkëlidhur mandati postar; 3. komunikim elektronik ndërmjet z. T. T. dhe subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi; 4. tabelë përmbledhëse për udhëtimet e shtetasit A. M. me pasaportën nr. {***}, me nr. {***}, lëshuar më datë 05.03.1996; 5. tabelë përmbledhëse për udhëtimet e shtetasit A. M. me pasaportën nr. {***}, me nr. {***}, lëshuar më datë 02.07.2001; 6. shkresa "Koment" mbi tabelat përmbledhëse, nga subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi; 7. vendim nr. {***}, datë 24.07.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse z. D. M. dhe palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe vendim nr. {***}, datë 26.10.2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse z. D. M. dhe palë të paditur Dhoma Kombëtare e Noterisë, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit.

³ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 03.12.2019.

⁴ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.02.2023.

⁵ Regjistruar në Kolegj me numër {***} prot., datë 15.01.2021.

konsiderohet person i lidhur apo person tjetër i lidhur për subjektin e rivlerësimit dhe se deri në çfarë kufijsh ekzistonte detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së saj. Subjekti i rivlerësimit, si në Komision, ashtu dhe parashtrimet e paraqitura në Kolegj, ka prapësuar se nëna e tij nuk mund të konsiderohet person i lidhur me të apo person tjetër i lidhur me të. Në deklaratën *vetting*, por edhe gjatë hetimit në Komision, nëna e subjektit nuk rezultoi në cilësinë e dhurueses, huadhënëses apo huamarrëses në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë ajo nuk kishte detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të saj. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrim ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive apartament dhe bono thesari, për sa kohë përfitimi/burimi i këtyre pasurive rezulton i provuar që është nga dëshmia e trashëgimisë e nënës së tij.

19. Në vlerësim të sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren nga aktet në fashikujt e Komisionit, se nëna e subjektit të rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin vetëm për periudhën 2005 - 18.04.2012⁶, para fillimit të procesit të rivlerësimit dhe, në kuptim të nenit 3, pika 13⁷ e ligjit nr. 84/2016, që përcakton rrethin e personave të lidhur, ajo nuk mund të konsiderohet si person i lidhur me subjektin.
20. Ndërsa, për sa i përket konsiderimit ose jo të nënës së subjektit si person tjetër i lidhur, trupi gjykues sjell në vëmendje se në kuptim të përkufizimit për “persona të tjerë të lidhur”, të dhënë nga neni 3, pika 14⁸ e ligjit nr. 84/2016, që personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit të konsiderohet i tillë, duhet të provohet një lidhje interesi mes tyre, që vjen si pasojë: i) e një interesi pasuror; ose ii) e çdo marrëdhënieje tjetër biznesi. Në këtë dispozitë parashikohet rrethi i personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit, një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e po këtij ligji. Në kuptim të kësaj dispozite, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur ka hyrë me këtë të fundit në një marrëdhënie huaje ose dhurimi.
21. Në rastin konkret, rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi të natyrës së huasë apo të dhurimit. Interesi pasuror që subjekti i rivlerësimit ka pasur/përfitur nga nëna e tij, pas vdekjes së saj në vitin 2019, sipas dëshmisë së trashëgimisë

⁶ Sipas shkesës nr. {***} prot., datë 3.6.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme e Gjendjes Civile, kthim përgjigje Komisionit, i cili ka kërkuar informacion për periudhën 2005-2016.

⁷ Neni 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: ““Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.

⁸Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: ““Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

ligjore, ka qenë pasuria bono thesari, në shumën prej 4.000.000 lekësh, dhe pasuria apartament me sipërfaqe 124,27 m² në Tiranë. Këto dy pasuri nuk kanë qenë pjesë e deklaratës *vetting* të subjektit, pasi janë përfituar pas plotësimit të saj dhe janë konstatuar nga Komisioni në kuadër të procesit të hetimit administrativ.

22. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, *prima facie*, nuk ka pasur detyrimin për të provuar gjatë procesit të rivlerësimit ligjshmërinë e dy pasurive të nënës, të cilat i kanë kaluar me trashëgimi, pasi nëna e tij nuk ka pasur statusin e personit të lidhur apo të personit tjetër të lidhur, dhe se, në kushtet e mungesës së një marrëdhënieje interesi, dy pasuritë e saj nuk mund t'i nënshtroheshin hetimit vetëm për faktin se subjekti i ka trashëguar ato. Por, trupi gjykues thekson se ky qëndrim do të ishte ezaurues vetëm në rastin kur nuk do të kishte pasur dyshime mbi mungesën e burimeve të ligjshme të nënës së subjektit për krijimin e këtyre dy pasurive, ashtu siç dhe ka konstatuar Komisioni gjatë procesit të hetimit, duke ngritur dyshime për pasuri të fshehura të subjektit.
23. Në raportin e rezultateve të hetimit, Komisioni ka konstatuar: *Duket se shtetasja T. I. është në pamjaftueshmëri financiare për investimin në bono thesari në vitin 2009, në shumën prej 4.000.000 lekësh [...]. Ngrihen dyshime se kjo pasuri (apartamenti) është krijuar qysh prej fillimit nga subjekti i rivlerësimit. Nëna e tij nuk rezulton me burime financiare të mundshme apo të disponuara prej saj për krijimin e kësaj pasurie. Të ardhurat e pretenduara të bashkëshortit të saj janë në shuma të paprovuara dhe të pabesueshme e, për më tepër, i përkasin një kohe relativisht të largët, e cila në një logjikë normale, nuk e bën të besueshme shfaqjen e tyre në vitin 2012 [...]. Është e paqartë arsyeja e investimit nga nëna e subjektit në blerjen e një pasurie të paluajtshme në një zonë preferenciale të Tiranës, e cila duket se nuk është përdorur prej saj e se ajo vazhdimisht ka deklaruar si adresë banimi apartamentin me qira në rrugën “{***}”.*
24. Komisioni, mbi bazën e këtyre konstatimeve, i ka konsideruar këto dy pasuri të dyshuara si pasuri të fshehura të subjektit, duke i kaluar atij barrën e provës për të provuar të kundërtën. Ky qëndrim i Komisionit për të shtrirë hetimin edhe mbi pasuritë e trashëguara nga subjekti, dhe për t'i kaluar atij detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pavarësisht se nëna e subjektit nuk është konsideruar person i lidhur/tjetër i lidhur nga Komisioni, është në përputhje me orientimin e Kolegjit se Komisioni nuk duhet të kufizohet të bëjë hetimet e nevojshme për të verifikuar dyshimet e ngritura për pasuritë, edhe pse subjektet e rivlerësimit nuk ngarkohen me barrën e provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se kontrolli i ligjshmërisë së të ardhurave për krijimin e këtyre dy pasurive, objekt ankimi nga Komisioneri Publik, të cilat nuk kanë qenë pjesë e deklaratës *vetting*, për shkak të fitimit të tyre nga trashëgimia ligjore, është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit lidhur me detyrimin që kanë organet e rivlerësimit për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se ajo mbahet në emër të personave të lidhur, të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me

subjektin e rivlerësimit në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016⁹.

25. Trupi gjykues i gjen të pabazuara në situatën faktike argumentet e subjektit të rivlerësimit se, nëse nëna e tij nuk do të kishte ndërruar jetë përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit, këto pasuri nuk do të hetoheshin nga Komisioni, dhe se nëse ai do të kishte pasur për qëllim fshehjen e pasurive në emër të nënës së tij, nuk kishte asnjë arsye për të kërkuar menjëherë lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë apo regjistrimin e këtyre pasurive në emër të tij. Trupi gjykues sjell në vëmendje se institucionet e rivlerësimit vlerësojnë dhe vendosin në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, bazuar në rrethanat specifike dhe objektive të çështjes në shqyrtim dhe jo në bazë të situatave apo sjelljeve hipotetike të subjekteve të rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se i njëjti hetim apo kontroll mund të ushtrohej prej Komisionit edhe në rast se nëna e subjektit do të ishte ende në jetë, në kushtet kur ngrihen dyshimet për pasuri të fshehura për rrethana që ekzistojnë dhe që nuk lidhen me ndërrimin e jetës, por me shkaqet e tjera të ngritura në ankim.
26. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij drejtuar Kolegjit, në mbështetje të argumenteve të tij për moskonsiderimin e nënës si person i lidhur apo person tjetër i lidhur, u është referuar disa vendimeve të mëparshme të Kolegjit për subjekte të tjera rivlerësimi, duke pretenduar ekzistencën e jurisprudencës së ngjashme, të cilën Kolegji duhet ta mbajë në konsideratë edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se argumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me statusin ligjor të nënës së tij në raport me procesin e rivlerësimit, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit për raste të tjera të ngjashme, konsiderohen si jorelevante, tërësisht jashtë kontekstit të rrethanave faktike të kësaj çështjeje, duke krijuar shtrembërim dhe konfuzion me qëllim shmangien nga kontrolli.
27. Për sa u përket shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik për dy pasuritë, apartament dhe bono thesari, lidhur me konkluzionet përfundimtare të Komisionit dhe pretendimet e subjektit, si dhe nga verifikimi i procesit të hetimit të zhvilluar në Komision dhe akteve përkatëse, analizohet si vijon.
28. Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, provat indirekte në lidhje me të ardhurat e mundshme të prindërve të tij, si dhe faktin që burimi primar i dy pasurive është trashëgimia, ka konkluduar se pasuritë apartament dhe bono thesari janë pasuri të krijuara nga nëna e subjektit të rivlerësimit në një mënyrë të ligjshme, të cilat ai i ka përfituar përmes trashëgimisë dhe se subjekti nuk mund të penalizohet për paqartësitë e mbetura lidhur me detajet e formimit të kursimeve të prindërve të tij.
29. Për këto dy pasuri, pas verifikimit të fashikujve të Komisionit, rezultojnë këto të dhëna:
 - i) *Për pasurinë bono thesari me vlerë 4.000.000 lekë*
30. Sipas informacionit që Banka e Shqipërisë i ka dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 09.09.2020, nëna e subjektit të rivlerësimit ka investuar në bono thesari në dhjetor 2008, me

⁹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 21/2020 (JR) – paragrafi 74, si dhe nr. 4/2021 (JR) – paragrafi 147.

datë emetimi të bonos së thesarit më datë 5.01.2009, shumën prej 4.000.000 lekësh, me afat 1-vjeçar. Më datë 31.12.2009, është shtuar vlera e bonos së thesarit në 4.500.000 lekë (shtuar 500.000 lekë) dhe është rinovuar çdo vit deri në datën 06.01.2020. Sipas kësaj shkrese, nëna e subjektit, znj. T. I., ka përfituar interesa bruto nga bonot e thesarit deri në vitin 2012 (viti i blerjes së apartamentit), prej 981.287¹⁰ lekësh. Për këta interesa, ashtu siç ka konkluduar Komisioni në vendim, sipas praktikave të ngjashme, është mbajtur dhe tatimi prej 10%, dhe vlera e interesave deri në vitin 2012, është të ardhura neto prej 883.158 lekësh.

31. Nga aktet e administruara nga Komisioni, nuk ka të dhëna që të vërtetojnë se znj. T. I. ka tërhequr interesa të paktën deri në vitin 2016, pasi më tej shumat janë transferuar në BKT Bank. Nga aktet nuk rezultojnë lëvizje të llogarisë në Bankën e Shqipërisë, që të vërtetojnë nëse interesat e bonos janë tërhequr (minimalisht deri në vitin 2012, momenti i blerjes së apartamentit), janë lënë në llogari apo një pjesë e tyre ka ndikuar në rritjen e vlerës së bonos së thesarit në vitin 2009, nga 4.000.000 lekë në 4.500.000 lekë (shtuar me 500.000 lekë në riinvestimin e bërë në datën 31.12.2009).
32. Nga viti 2016 e deri në vitin 2019, konstatohet se interesat e bonove të thesarit janë kredituar dhe janë tërhequr në llogarinë e znj. T. I. në BKT Bank (interesi i fundit i vitit 2019 është tërhequr nga subjekti sipas dëshmisë së trashëgimisë në datën 19.12.2019).
33. Në datën 06.01.2020, vlera prej 4.490.961 lekësh ka kaluar në llogarinë e znj. T. I. Më datë 08.01.2020, kjo shumë ka kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin: *T. I. për Erabër Madhi, kalim sipas vendimit të trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., {***} kol., datë 31.05.2019.*

ii) Për pasurinë apartament me sip. 124,27 m², me vendndodhje në Tiranë

34. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Jug, me shkresën nr. {***}, datë 07.02.2022 dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 09.10.2020, drejtuar Komisionit, ka konfirmuar pronësinë e apartamentit me sip. 124,27 m², nr. {***}, në emër të subjektit të rivlerësimit, me datë regjistrimi sipas kartelës datë 01.07.2019, si dhe ka përcjellë dokumentacionin nga i cili vërtetohet se nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2012, shtetasit S. dhe Z. H. i kanë shitur nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. T. I., këtë pasuri sipas çmimit të rivlerësimit prej 16.776.450 lekësh¹¹, shumë e cila është likuiduar brenda në zyrën noteriale nga blerësja te shitësit dhe më pas është regjistruar në pronësi të saj në datën 23.04.2012.
35. Me aktin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.5.2019, është përcaktuar subjekti si trashëgimtari i vetëm ligjor i të gjitha pasurive të trashëgimlënësës T. I., e cila ka ndërruar jetë në datën 17.4.2019. Në vijim është bërë edhe regjistrimi i pasurisë apartament në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në datën 01.07.2019, në emër të subjektit të rivlerësimit.

¹⁰ Si total i interesave në datat e maturimit të bonove: më 31.12.2009, prej 318.369 lekësh; më 30.12.2010, prej 372.926 lekësh; më 29.12.2011, prej 289.992 lekësh = 981.287 lekë.

¹¹ Rivlerësimi i apartamentit është kryer më datë 09.04.2012.

36. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 18.9.2020, të Furnizuesit të Shërbimit Universal, rezulton se për kontratën e furnizimit me energji elektrike të znj. I., për periudhën qershor 2012 - maj 2019, në apartamentin në fjalë nuk ka pasur konsum energjie dhe është paguar vetëm tarifa bazë, (me vlera faturash që variojnë nga 109,24 - 658,6 lekë/muaj).
37. Këtë apartament, subjekti e ka deklaruar si vendbanim, nga qershori 2019, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2019, si dhe gjatë hetimit në Komision, në përgjigjet e pyetësorit standard e në vijim.
38. Për të dyja pasuritë e mësipërme, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se kanë si burim kursimet e gjithë jetës së nënës dhe babait të tij dhe se: *Me vdekjen e tim eti, pavarësisht se unë isha një nga trashëgimtarët e tij, të gjitha shumat e kursimeve familjare i mbetën tërësisht të ndjerës nënës sime, për shkak se moralisht unë asnjëherë nuk kisha kontribuar në krijimin e tyre dhe, për pasojë, nuk mund të kisha asnjë pretendim mbi këto kursime.*
39. Komisioni, në përfundim të vlerësimit për këto dy pasuri, ka çmuar se *duke mos u kristalizuar një pamjaftueshmëri e qartë mjetesh financiare për nënën e subjektit lidhur me krijimin e pasurive në analizë dhe në mungesë të provës së dhënies të ndonjë kontributi financiar nga ky i fundit, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit, si dhe duke mbajtur në konsideratë vështirësitë dhe pamundësitë e konstatuara përgjatë hetimit administrativ për të hedhur dritë mbi saktësimin sasior të kursimeve të mundshme të realizueshme nga prindërit e subjektit, në dekadat pararendëse nuk mund të mjaftojë vetëm fakti i përfitimit final të këtyre sendeve, për më tepër nëpërmjet aktit të trashëgimisë ligjore për të penalizuar subjektin e rivlerësimit.*
40. Sipas hetimit të zhvilluar në Komision, ka rezultuar se të ardhurat e nënës, sipas shkresës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën qershor 2015 - dhjetor 2018¹², kanë qenë pension familjar mujor 15.346 lekë bruto, si dhe pension suplementar prej 6.689 lekësh bruto. Gjithashtu, konfirmohet se nëna e subjektit ka përfituar shumën 1.200.000 lekë nga shitja e një apartamenti 53 m², të ndodhur në Tiranë, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2005 (3/4 e pjesës takuese të vlerës së shitjes 1.600.000 lekë)¹³. Nëna e subjektit ka përfituar dhe shpërblim për përdorimin e sendit, një shtëpi private në bashkëpronësi, në shumën 11.000 lekë, sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***}, datë 02.07.2007 (përfunduar në datën 08.05.2014 në Gjykatën e Lartë), me debitor vëllain e saj¹⁴. Në vijim të konkluzionit të Komisionit,

¹² ISSH-ja, me shkresën nr. {***}, datë 07.02.2022, informon se të dhënat e disponuara për shtetasen T. I. janë nga viti 2012.

¹³ Subjekti, në përgjigjet e rezultateve hetimore, ka referuar se apartamenti realisht është shitur në vlerën prej 5.800.000 lekësh dhe se gjithë shuma i ka kaluar nënës së tij. Sipas akteve në fashikuj, bashkëlidhur praktikës së sjellë nga ASHK-ja, blerësit e apartamentit (që e blenë më 22.09.2005) e kanë shitur më pas atë në dhjetor 2005, në vlerën prej 3.000.000 lekësh.

¹⁴ Nuk ka akte që të vërtetojnë marrjen e këtij dëmshpërblimi të paktën deri në 14.10.2014, kur kanë filluar kalimet në BKT Bank e në vijim. Nga hetimi në Komision i lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasës T. I. në BKT, ka rezultuar se është kredituar me transfertë shuma prej 80.000 lekësh në datën 14.10.2014, dhe në Raiffeisen Bank ka rezultuar se është kredituar me transfertë shuma 120.000 lekë, në datën 23.3.2015, me përshkrimin: "Pagesë nga zyra përmbartimore Tiranë, për pagesë detyrimi nga shtetasi A. I."

të ardhurat nga interesat neto nga bonot e thesarit deri në vitin 2012, kanë qenë në shumën 883.158 lekë.

41. Në vlerësim të konstatimit të Komisionerit Publik se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk mund të ketë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar investimin në këto dy pasuri, në Kolegj, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se për periudhën 1997-2008 (që i korrespondon blerjes së bonove të thesarit), të ardhurat e nënës janë në vlerën 1.600.000 lekë. Në këtë rezultat janë marrë të mirëqena deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se gjithë të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2005, prej 1.600.000 lekësh, i ka përfituar vetëm nëna e tij. Për periudhën 1997-2012, duke shtuar dhe shumën nga interesat e bonove në vlerën 883.158 lekë¹⁵, të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit rezultojnë të jenë në total në vlerën 2.483.158 lekë.
42. Për sa i përket shitjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, në vitin 2005, nga shitja e të cilit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka përfituar asnjë të ardhur, trupi gjykues, pas verifikimit të deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti, konstaton se në deklaratën e vitit 2005, subjekti, megjithëse ka pasur detyrim ligjor, nuk ka deklaruar pjesën e përfituar në pronësinë e apartamentit, sipas dëshmisë së trashëgimisë lëshuar për babain e tij, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit, sipas kontratës përkatëse.
43. Për sa u përket të ardhurave të babait, trupi gjykues vëren se gjatë hetimit, Komisioni i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”), Bankës Raiffeisen dhe Ministrisë së Mbrojtjes, me kërkesë për informacion mbi të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit.
44. Në përgjigjen e ISSh-së drejtuar Komisionit me shkresën nr. {***}, datë 22.09.2022, sipas vërtetimit për efekt pensioni, jepen të dhëna për të ardhurat nga punësimi i babait të subjektit në Forcat e Armatosura për vitet 1974, 1988, 1989, 1990, 1992, për periudhën korrik 1997 - dhjetor 2000, informacion për trajtimin me pagesë kalimtare për periudhën 01.01.2003 - 01.01.2005, si dhe për punësimin nga data 16.01.2003, si specialist pranë Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
45. Nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***}, datë 28.09.2022, informohet Komisioni se në llogarinë e z. A. M., rezultojnë tri kreditime pagash për 3 muaj nga Ministria e Mbrojtjes, në shumën totale 34.004 lekë (kaluar në datën 05.05.2005, shuma prej 11.715,2 lekësh; në datën 16.05.2005, shuma prej 17.319,5 lekësh dhe në datën 30.05.2005, shuma prej 4.968,84 lekësh).
46. Ministria e Mbrojtjes, me shkresën nr. {***} prot., datë 6.10.2022, ka informuar Komisionin se shtetasi A. M. ka shërbyer si ushtarak aktiv me gradën Kolonel e ka kryer detyra të ndryshme për periudhën nga viti 1964 – 2002, dhe në vitin 2002 ka dalë në rezervë. Gjithashtu, në këtë shkresë, ministria ka informuar se lidhur me angazhimin në aktivitete/projekte, si NATO/OPCW etj., apo dhe për aktivitete të tjera, ai nuk është trajtuar financiarisht nga strukturat e kësaj ministrie, por

¹⁵ Komisioni ka pranuar se nëna e subjektit ka përfituar dhe interesat nga bonot e thesarit, në vlerën prej 883.158 lekësh, por nuk ka akte në fashikuj që të provojnë se këto interesa janë tërhequr prej saj.

është trajtuar nga strukturat e NATO-s dhe nga organizatat me të cilat është angazhuar e, për rrjedhojë, ministria konfirmon se nuk ka informacion në lidhje me pagesat e përfituara. Ministria ka informuar se për kurset jashtë vendit, shtetasi A. M. është trajtuar financiarisht me pagën bazë si ushtarak aktiv, ndërsa për trajtime financiare të mundshme të shteteve pritëse, nuk ka informacion.

47. Në përfundim të hetimit, Komisioni, bazuar në të dhënat nga dokumentacioni i dërguar nga ISSH-ja dhe ministria, ka konkluduar se të ardhurat e babait për të gjithë periudhën nga viti 1997 deri në vitin 2005, kanë qenë në vlerën neto prej 1.898.399 lekësh¹⁶.
48. Subjekti ka listuar në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit në Komision, të ardhurat që ka përfituar i ati gjatë punësimit në Forcat e Armatosura, si ekspert në disa organizma ndërkombëtare, si dhe të ardhurat nga pagesat e honorarëve dhe dietave nga aktivitetet jashtë vendit. Si dokumentacion provues për të ardhurat e të atit, subjekti ka paraqitur në Komision: (i) fotokopje të pasaportave të babait të tij, ku evidentohet një numër i konsiderueshëm vizash, si dhe hyrje-dalje të shumta të babait të subjektit; (ii) certifikatë pjesëmarrjeje e babait në konferencën ndërkombëtare mbi mjedisin ushtarak, zhvilluar në Pekin më 12 - 14 tetor 2004; (iii) shkresë e Shtabit të Përgjithshëm me logo të flamurit zviceran, e cila i dërgohet babait të subjektit në cilësinë e Drejtuesit të Autoritetit Kombëtar të Shqipërisë, në lidhje me marrëdhëniet me CWC, sipas së cilës babai i subjektit ka marrë pjesën në kursin CIPTRO IV, më 22 - 27 prill 2001; (iv) vërtetim nga Agjencia e Prokurimit të Mbrojtjes me logo të flamurit zviceran, që mban datën 28.01.2002, sipas të cilit vërtetohet se babai i subjektit ka kontribuar në projektin VETOXA, në cilësinë e koordinatorit të projektit, për periudhën 1998 – 2001; (v) certifikatë për kursin e trajnimit mbi Verifikimin e Agjentëve Kimikë të luftës më 20 gusht - 14 dhjetor 2001; (vi) certifikatë pjesëmarrjeje në trajnimin mbi Mbrojtjen Civile, periudha 9 - 14 gusht 1999; (vii) certifikatë për përfundimin e trajnimit NBC NATO për periudhën 19 - 23 janar 1998, lëshuar nga NATO SCHOOL; (viii) letër mikpritëse në Shkollën e Mbrojtjes NBC dhe Vetëmbrojtjes; (ix) një fotografi nga Konferenca e Paqes, organizuar nga USEUCOM në vitin 1999; (x) urdhri “Naim Frashëri, Klasi III”; (xi) certifikatë pjesëmarrjeje, lëshuar nga NATO SCHOOL për kursin mbi mbrojtjen e mjedisit nga forcat ushtarake, më 17-28 nëntor 2003; (xii) certifikatë pjesëmarrjeje në Simpoziumin e Trajtimit Mjekësor Kimik dhe Biologjik, më 28 prill - 3 maj 2002; (xiii) certifikatë pjesëmarrjeje në NATO Working Group 2, më 24.8.2000; (xiv) certifikatë pjesëmarrjeje, lëshuar nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së për kursin mbi armët e shkatërrimit në masë, më 19 - 23 janar 2004; (xv) fotografi të babait të tij në evente të ndryshme ndërkombëtare.
49. Për të vërtetuar të ardhurat e të atit pranë NATO-s dhe OPCW-së (Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike), subjekti i rivlerësimit u ka dërguar këtyre dy institucioneve, më datë 02.11.2022,

¹⁶ Ndryshe nga Komisioni, në Kolegj, sipas vërtetimeve bashkëlidhur shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes, konstatohet se babai i subjektit, për periudhën 1997 – 2004, ka përfituar paga neto në total prej 2.021.540 lekësh. Referuar vërtetimeve bashkëlidhur: a) nr. {***}, për bazë të vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën korrik 1997 – dhjetor 2002, totali i të ardhurave neto – prej 1.464.260 lekësh; b) nr. {***}, datë 05.10.2022, për bazë të vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën janar - korrik 1997, totali i të ardhurave neto – prej 63.240 lekësh; c) nr. {***} prot., datë 05.10.2022, për trajtim me pagesë kalimtare të ushtarakut në rezervë, për periudhën 1.01.2003 – 1.01.2005, në të cilën jepet paga bruto mujore sa 50% e pagës bruto mujore e dhjetorit 2002, e referuar pagës neto mujore, 50% e pagës neto mujore e dhjetorit 2002 për periudhën 2003-2004, në total rezultojnë të ardhura neto prej 494.040 lekësh.

si dhe përsëri më datë 29.03.2023, kërkesë për informacion mbi angazhimin, si dhe të ardhurat dhe dietat e z. A. S. M.. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë marrë një përgjigje zyrtare për sa ka kërkuar nga këta dy organizma ndërkombëtarë. Gjithashtu, nga aktet, nuk rezulton që subjekti t'u jetë drejtuar institucioneve/organizmave të tjera për të marrë të dhëna për sa ka deklaruar në Komision lidhur me angazhimet e tjera profesionale të babait, si brenda dhe jashtë vendit.

50. Për sa i përket konstatimit të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacionin mbi të ardhurat e të atit, të pretenduar nga subjekti si në Komision, ashtu dhe në Kolegj, rezulton se subjekti ka tentuar të sigurojë informacion nga dy organizatat, NATO dhe OPCW, duke dërguar në adresë të tyre, më datë 02.11.2022, kërkesë për të dhëna lidhur me angazhimet e babait, si dhe duke kërkuar dhe shtyrje të afatit për dorëzimin e prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit në Komision, kërkesë që i është pranuar¹⁷. Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në seancën e datës 04.07.2023, subjekti i rivlerësimit kërkoi kohë për të pritur përgjigje nga përfaqësia shqiptare pranë NATO-s, lidhur me aktet e kërkuara prej tij. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, pranoi kërkesën e subjektit për të caktuar një seancë në një datë të mëvonshme¹⁸, por rezultoi se përsëri subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sigurojë një përgjigje zyrtare nga dy organizatat e mësipërme. Gjithashtu, rezulton nga aktet se edhe nga Ministria e Mbrojtjes është dërguar një kërkesë në OPCW, me qendër në Hagë, por sipas shkresës së ministrisë nr. {***}, datë 5.12.2022, nuk është marrë asnjë përgjigje nga kjo organizatë deri në atë datë. Ndërkohë, po nga aktet e administruara në Komision, konstatohet se përfaqësia e Republikës së Shqipërisë në NATO, në shkresën nr. {***}, datë 11.11.2022, duke u shprehur se: *Kolonel M. mund të ketë shërbyer si ekspert në OPCW, me miratim nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria për Evropën dhe Punën e Jashtme*, ka orientuar Komisionin që t'i drejtohet MEPJ-së, si dhe Përfaqësueses së Përhershme të Republikës së Shqipërisë në OPCW, për të vërtetuar të ardhurat e mundshme financiare të përfituara si ekspert i angazhuar me këtë organizatë për periudhën e kërkuar. Nga aktet në fashikuj, nuk rezultojnë korrespondenca të Komisionit me MEPJ-në apo me përfaqësuesen e përhershme të Republikës së Shqipërisë në OPCW, për kërkesë informacioni.
51. Lidhur me hetimin e zhvilluar në Komision për të ardhurat e babait, trupi gjykues vëren se, bashkëlidhur shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes, është dërguar urdhri nr. {***}, datë 08.03.2000, i Ministrisë së Mbrojtjes për pjesëmarrjen e babait të subjektit në një grup pune (Grupi Koordinativ i Punës për tryezën e tretë të Paktit të Stabilitetit), por pa pasur të dhëna lidhur me pagesat/honorarët nga kjo pjesëmarrje. Për këtë të dhënë, si nga Komisioni, ashtu dhe nga subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur përpjekje të mëtejshme për të siguruar informacion më të detajuar nga ky institucion.
52. Trupi gjykues, në konkluzion të sa më sipër, konstaton se të ardhurat e provuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit (2.483.158 lekë për nënën dhe 2.021.540 lekë¹⁹ për babain) janë dukshëm

¹⁷ Komisioni, në korrespondencën me subjektin, i ka tërhequr vëmendjen në faktin se është njohur me barrën e provës që në datë 11.10.2022, dhe duhet të kishte vepruar më parë për mbledhjen e informacionit.

¹⁸ Subjekti i rivlerësimit i kërkoi 2 javë kohë Kolegjit për të siguruar përgjigje zyrtare nga organizata NATO.

¹⁹ Referuar akteve në fashikujt e Komisionit, trajtuar më sipër në këtë vendim.

shumë më të ulëta se vlera prej 20.776.450 lekësh²⁰ që kanë qenë investimet e nënës për bono thesari dhe blerje apartamenti, në vitet 2008²¹ dhe 2012, me burim të pretenduar nga kursimet e gjithë jetës, të krijuara nga të dy prindërit (1997-2005).

53. Për sa i përket mënyrës së mbajtjes dhe ruajtjes së të ardhurave dhe kursimeve të prindërve, subjekti ka sqaruar gjatë hetimit në Komision, në parashtrimet në Kolegj dhe në përgjigjet e pyetjeve në seancë gjyqësore, se ato janë ruajtur në banesë nga nëna e tij pasi, sipas tij: *Deri në momentin e ndërrimit të jetës së babait tim, në mënyrë të papritur, në maj të vitit 2005, të gjitha këto shuma kursimi që më rezultojnë të ishin të larta, me sa jam në dijeni, janë mbajtur nga prindërit jashtë sistemit bankar, duke qenë se më rezulton se të dy ishin të ndikuar nga mosbesimi në sistemin bankar, për shkak të ngjarjeve të vitit 1996 – 1997, kur ndodhi edhe falimentimi i skemave piramidale dhe, po kështu, rrënimit në atë periudhë të sistemit bankar shqiptar.* Trupi gjykues konstaton se ky fakt (mbajtja në banesë e një shume të konsiderueshme të kursimeve) jo vetëm mbetet deklarativ dhe i paprovuar nga subjekti, duke konsideruar sigurinë që mund të ofrojë banesa e babait (apartament në katin e parë të një pallati të ndërtuar para viteve '90), por rezulton se nuk përkon dhe me sjelljen e mëvonshme të nënës së tij, e cila në vitin 2008 ka investuar në bono thesari, duke përfituar edhe interesa vjetorë nga ky investim. Për trupin gjykues, mbetet i pabesueshëm dhe jobindës fakti se përse këto kursime janë vazhduar të mbahen në banesë, në gjendje *cash*, për periudhën 2005-2008 (dhe pjesa më e madhe deri në vitin 2012), dhe pse nëna e subjektit, duke disponuar një vlerë të konsiderueshme kursimesh, të pretenduar afërsisht në shumën 350.000 USD, sipas deklarimeve të subjektit, ka investuar vetëm shumën 4.000.000 lekë në fund të vitit 2008.
54. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë deklaram në deklaratat periodike vjetore të vitit 2005, si dhe të viteve më pas, për kursime të mundshme në *cash* të të atit, të pretenduara të trashëguara pas vdekjes së tij prej nënës së subjektit. Pavarësisht pretendimit se këto kursime janë përfituar tërësisht vetëm nga e ëma, subjekti ligjërisht, si trashëgimtar ligjor i babait të tij, ishte përfitues me ½ e pjesës së babait dhe, në përmbushje të detyrimit ligjor, duhet të deklaronte përfitimin ose dhurimin ndaj nënës së pjesës së tij takuese nga këto kursime. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, nuk rezulton të jetë bërë ky deklaram nga subjekti, ashtu si nuk është bërë dhe deklarimi i pjesës takuese dhe i shumës që ka përfituar nga shitja e apartamentit në rrugën “{***}”, trajtuar më sipër në këtë vendim. Trupi gjykues vëren se pavarësisht se ky mosdeklaram nuk e ngarkon me përgjegjësi subjektin në kuadrin e procesit të rivlerësimit, ai ka vlerë në drejtim të provueshmërisë së deklarimeve të tij në kuadër të këtij procesi. Në mungesë të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore, përjashtohet edhe një nga mundësitë që ka pasur subjekti i rivlerësimit për të provuar ekzistencën dhe përfitimin e kursimeve nga prindërit.

²⁰ Ose 21.276.450 lekë, pra 500.000 lekë më shumë, duke konsideruar se vlera e bonove të thesarit, sipas akteve nga Banka e Shqipërisë, rezultoi në riinvestimin e bonos së thesarit më datë 31.12.2009, vlera e saj ishte 4.500.000 lekë, pra duke u shtuar me 500.000 lekë nga investimi fillestar prej 4.000.000 lekësh.

²¹ Sipas informacionit që Banka e Shqipërisë i ka dërguar Komisionit, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.09.2020, nëna e subjektit të rivlerësimit ka investuar në bono thesari në dhjetor 2008, me datë emetimi të bonos së thesarit më datë 05.01.2009, shumën prej 4.000.000 lekësh.

55. Një nga rrethanat objektive të konstatuara në ankim nga Komisioneri Publik (si dhe nga vëzhguesit e ONM-së), ka të bëjë me deklaratimet tërësisht kontradiktore të subjektit mbi vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2019. Lidhur me këto deklaratime, nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti, në procesin e hetimit në Komision, në pyetëtorin standard për periudhën shtator 2004 - qershor 2019, ka deklaruar si adresë banimi: “Njësia Bashkiake Nr. {***}, rruga “{***}”, Pallati {***}, Shk. {***}, Ap. {***}, apartament marrë me qira prej tij”. Këto deklaratime të subjektit rezultojnë se janë të ndryshme nga deklaratimet e tij të mëparshme në ILDKPKI. Sipas procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI më datë 01.08.2014, subjekti ka deklaruar se jeton në shtëpinë e nënës së tij, në adresën e dhënë në deklaratimet periodike²² – rruga “{***}”, Tiranë – e cila jeton me qira dhe pagesa e qirasë, në shumën 25.000 lekë në muaj, paguhet nga ajo. Ndërsa në Komision, gjatë hetimit, për periudhën 2007 - 2013, subjekti ka deklaruar se ka banuar në një apartament me qira të marrë në Vlorë, në procesverbalin e datës 01.08.2014 të ILDKPKI-së, ai ka deklaruar se për periudhën 2004-2013, gjatë së cilës ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Fier dhe Vlorë, ka kryer vajtje-ardhje dhe në disa raste ka jetuar te të njohurit pa pagesë.
56. Për sa i përket adresës së banimit të nënës dhe përdorimit të apartamentit të blerë në vitin 2012, subjekti ka deklaruar në Komision, në përgjigje të pyetëtorit, datë 19.4.2022, se: *Në lidhje me pyetjen tuaj nëse jam në dijeni për çfarë është përdorur apartamenti nga viti 2012 deri në vitin 2019, me vdekjen e trashëgimlënësës, dua të sqaroj se asnjëherë nuk jam interesuar në detaje në lidhje me mënyrën e përdorimit të pasurive të prindit tim, por me sa jam në dijeni, pasuria është përdorur për banim nga e ndjera (duke qenë se herë pas here banonte edhe në shtëpinë private në bashkëpronësi, të trashëguar prej prindërve të saj), dhe në periudha të caktuara mund dhe ta ketë dhënë me qira. Këto deklaratime të subjektit, të përsëritura edhe me parashtrimet në Kolegj, për përdorimin e apartamentit nga nëna, bien në kundërshtim me të dhënat nga OSHE-ja, të cilat konfirmojnë se për këtë apartament, nuk ka pasur konsum për periudhën qershor 2012 - prill 2019, sipas kontratës së furnizimit në emër të nënës së subjektit. Nga këto të dhëna, rezulton se apartamenti në fjalë për këtë periudhë, nuk është përdorur për banim nga nëna e subjektit apo nuk u është dhënë me qira të tretëve, duke rrëzuar pretendimin e subjektit.*
57. Lidhur me adresën e banimit të nënës, ndryshe nga sa kishte deklaruar më parë në ILDKPKI, në seancën dëgjimore të datës 10.02.2023 në Komision, si dhe në parashtrimet e sjella në Kolegj, subjekti ka deklaruar se, që nga shitja e apartamentit në vitin 2005, nëna e tij ka vijuar të banojë në pasurinë e trashëguar nga prindërit e saj, në rrugën “{***}”, Tiranë. Në verifikim të këtyre deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}, datë 2.07.2007, me palë ndërgjyqëse nënën e subjektit dhe vëllain e saj, rezulton se pjesa e takuese e nënës së subjektit përdorej nga pala e paditur A. I. (vëllai i saj), dhe me këtë vendim asaj iu njoh e drejta e kërkuar me padi për përdorim të pjesës takuese të shtëpisë së

²² Konstatohet se në deklaratat periodike vjetore prej vitit 2005 deri në vitin 2009, subjekti ka deklaruar si adresë banimi, apartamentin me qira në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 2010 ka deklaruar adresë banimi në Vlorë, dhe në vitet 2011-2017 përsëri ka deklaruar apartamentin në rrugën “{***}”.

prindërve (konfirmuar me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë të datës 16.04.2014). Gjithashtu, rezulton se nëna e subjektit ka deklaruar në Bankën e Shqipërisë në vitin 2008, dhe në BKT në vitet 2014-2015, si adresë banimi apartamentin me qira në rrugën “{***}”, Tiranë, fakt i kundërshtuar nga subjekti si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, duke pretenduar se ky deklaram është bërë thjesht për dërgimin e njoftimeve postare.

58. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, si në Komision, ashtu dhe në parashtrime, si edhe në përgjigje të pyetjeve të bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar gjatë seancave gjyqësore në Kolegj, ka deklaruar vazhdimisht se ka pasur një marrëdhënie të ftohtë për një periudhë të gjatë kohore me nënën, e cila ka jetuar më vete, dhe se nuk ka pasur dijeni mbi të ardhurat dhe kursimet e prindërve të tij apo mbi përfitimet e nënës nga trashëgimia nga familja e saj. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se është në kundërshtim me rrethanat faktike të evidentuara nga hetimi në Komision, si dhe nga aktet, nga të cilat rezulton se disa nga veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të lidhura me ato të kryera nga nëna e tij, siç është rasti i ndarjes nga certifikata familjare disa ditë pas blerjes së apartamentit nga nëna apo deklarimi prej saj në bankë i së njëjtës adresë banimi me të birin. Trupi gjykues vlerëson se këto deklarime kontradiktore dhe të paprovuara të subjektit të rivlerësimit janë bërë me qëllimin e vetëm për të krijuar një distancë fiktive dhe, për rrjedhojë, një alibi/justifikim për mosprovimin prej tij të së kundërtës së disa prej gjetjeve të dala gjatë hetimit në Komision.
59. Gjithashtu, rezultojnë të pabazuara dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ndarja nga certifikata familjare është bërë me kërkesë të nënës së tij, veprim krejtësisht i saj, i pandikuar nga ana e tij. Nga përmbajtja e shkresës nr. {***} prot., datë 1.06.2022, të Drejtorisë së Gjendjes Civile, në të cilën informohet se shtetasi *Erarbër Madhi rezulton të jetë veçuar nga trangu familjar*, si dhe bazuar në procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm²³ për veçimin nga trangu familjar, del se kërkesa është bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit.
60. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se nëse deklaramet kontradiktore të subjektit lidhur me vendbanimin e tij dhe të nënës së tij, do të ishin e vetmja paqartësi/pasaktësi në deklaramet e tij gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, nuk do të përbënin indicie të mjaftueshme për t’i lidhur me dyshimet për një fshehje të pasurisë prej tij. Por, pasi rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë se prindërit e tij kanë pasur mjaftueshëm të ardhura dhe kursime të mbajtura në banesë, të cilat i kanë shërbyer nënës së tij për krijimin e dy pasurive objekt shqyrtimi gjyqësor, shtuar edhe elemente të tjera, si: kujdesi për të evidentuar qartë faktin që pagesa e shtëpisë është bërë nga nëna e tij në prezencë të noterit, mospërdorimi asnjëherë i apartamentit nga nëna e subjektit, veprimet e subjektit për ndarjen nga certifikata familjare menjëherë pas blerjes së apartamentit, deklaramet konsistente të subjektit për një marrëdhënie të ftohtë dhe të distancuar me nënën, në kundërshtim me faktet e evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit; krijohen dyshime të arsyeshme se të gjitha këto veprime janë bërë në funksion të fshehjes së pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Konstatimi i pamjaftueshmërisë financiare të nënës, që vjen kryesisht si rrjedhojë e

²³ Sipas dispozitave të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

mosprovimit të të ardhurave të bashkëshortit të saj, si dhe fakti që subjekti nuk arrin të provojë kursimet e prindërve të mbartura deri në vitin 2005, janë elemente që çojnë në dyshimin për fshehje të pasurive bono thesari dhe apartament, dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e këtyre dyshimeve, ai ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

61. Në përfundim, për pasuritë, apartament banimi me sipërfaqe 124,27 m², në Tiranë, si dhe bono thesari me vlerë 4.000.000 lekë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk provon bindshëm ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe të kursimeve të prindërve të tij, të cilat pretendon se kanë shërbyer për krijimin e këtyre dy pasurive, pasi analizoi rrethanat objektive të mëposhtme.
- (i) Investimet në vlera të konsiderueshme të nënës së subjektit të rivlerësimit, prej 4.000.000 lekësh në bono thesari në vitin 2009, si dhe prej 16.776.450 lekësh për blerjen e apartamentit në vitin 2012, ndërkohë që subjekti nuk arriti të provojë se prindërit e tij mund të kenë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme me burim të ligjshëm për krijimin e këtyre pasurive.
 - (ii) Pamundësia për të provuar ekzistencën e kursimeve në *cash*, në vlerën 350.000 USD, të pretenduara të mbajtura në banesë nga prindërit e subjektit për një periudhë disavjeçare, deri në investimin e tyre në vitet 2009 dhe 2012.
 - (iii) Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar vetëm katër ditë pas blerjes së apartamentit nga nëna e tij, më datë 14.04.2012, ndërkohë që pasuritë e mësipërme janë krijuar gjatë periudhës që subjekti ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me të ëmën gjatë ushtrimit të funksionit.
 - (iv) Mosdeklarimi në deklaratat periodike vjetore të të drejtave pasurore të fituara nga trashëgimia ligjore pas vdekjes së të atit në vitin 2005.
 - (v) Mospërdorimi nga nëna e subjektit të rivlerësimit i apartamentit të blerë prej saj në vitin 2012, për jetesë apo për të krijuar të ardhura.
 - (vi) Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit të tij dhe të nënës për periudhën 2004-2019, në shtëpitë e marra me qira, të cilat pamundësojnë sqarimin e situatës faktike sa i përket bashkëjetesës së tyre, veçanërisht në vitet 2005-2012.
62. Për rrjedhojë, në vlerësimin tërësor të rrethanave të mësipërme, arrihet në përfundimin se këto dy pasuri nuk e kanë burimin nga të ardhurat e prindërve, por nga burime të padeklaruara prej subjektit të rivlerësimit. Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se pretendimi i ngritur nga Komisioneri Publik se këto pasuri janë të fshehura, është i drejtë dhe i bazuar në fakte e në ligj.
63. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “c”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit nr. 621, datë 13.02.2023, duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i bazuar në fakte, në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 621, datë 13.02.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 27.07.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi